

VENDIM
Nr. 1111, datë 24.12.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 262, DATË 6.4.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE
ZHVILLIMIT EKONOMIK NË SPITALLË, DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar; me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 262, datë 6.4.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” të territorit me sipërfaqe 49.1 (dyzet e nëntë pikë një) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, në Spitallë, Durrës, në përbërje të së cilës janë parcelat me numra pasurie, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Pika 7 shfuqizohet.

3. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.”.

4. Lista e pasurive që do të përfshihen në “Zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” Spitallë, Durrës, përmendur në pikën 1 dhe bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.


5. Harta, përmendur në pikën 2 dhe bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me hartën bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Lista e pasurive që do të përfshihen në “Zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” Spitallë, Durrës, faza e parë, dhe harta, përmendur në pikën 7 dhe bashkëlidhur vendimit, hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

HARTA E " ZONES SE TEKNOLOGJISE DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK"
SPITALLË, DURRËS (49.1 HA)



LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “ZONËN E TEKNOLOGJISË
DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK” SPITALLË, DURRËS

Nr.	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²
1	8,517	78	Arë	146,640
2	8,517	79/1	Arë	99,770
3	8,517	80/1	Arë	104,580
4	8,517	81	Arë	140,400
	TOTAL			491,390

LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “ZONËN E TEKNOLOGJISË
DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK” SPITALLË, DURRËS

Nr.	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²
1	8,517	78	Arë	146,640
2	8,517	79/1	Arë	99,770
3	8,517	80/1	Arë	104,580
4	8,517	81	Arë	140,400
	TOTAL			491,390

